

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për mbrojtjen civile”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mbrojtjes
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i <i>ACQUIS</i> të BE
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	- Direktiva 2008/114/KE, datë 8.12.2008 “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Numri CELEX 32008L0114, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, Nr.345/75, datë 23.12.2008, faqe 75-83; - Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23.10.2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmytjeve”, Numri CELEX 32007L0060, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian seria L , 288/27, datë 6.11.2007, faqe 27-35, - Direktiva 2012/18/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 4.07.2012 “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, duke ndryshuar dhe më pas duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 96/82 / EC” (Direktiva Seveso), Numri CELEX 32012L0018, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L , Nr.197/1, datë 24.07.2012, faqe 1-38; - Direktiva 2002/22/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit edatës 7.03.2002 “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal), Numri CELEX 32002L0022, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian seria L , 108, datë 24.04.2002, faqe 51-77; - Vendimi i Këshillit i datës 23.10.2001 “Krijimi i një Mekanizmi të Mbrojtjes Civile për të lehtësuar bashkëpunimin e përforcuar në ndërhyrjet e asistencës për mbrojtjen civile (2001/792/EC, Euratom)”, Numri CELEX 32001D0792, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian seria L, 297, datë 15.11.2001, faqe 07-11; - Vendimi (BE) 2019/420 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, datë 13.03.2019 që amendon Vendimin Nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Për Mekanizimin e BE-së për Mbrojtjen Civile”, Numri CELEX 32019D0420, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian seria LI 77/1, datë

	20.3.2019, faqe 01-15; Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2018/142 i datës 15.01.2018 për ndryshimin e Vendimit Zbatues 2014/762/BE, i cili përcakton rregullat për zbatimin e Vendimit Nr 1313/2013 / BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Mekanizmin e Bashkimit të Mbrojtjes Civile (njoftohet nën dokumentin C (2018) 71) (Tekst me rëndësi për ZEE) Numri CELEX 32018D0142, Fletorja zyrtare e Bashkimit Evropian seria L 25/40, datë 30.1.2018, faqe 40-48;
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar me VKM nr. 348, datë 11.05.2015.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	12.11.2018
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	29.05.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 29.05.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MM – Nr.3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Herta Shehri: herta.shehri@mod.gov.al Romina Hoxha: romina.hoxha@mod.gov.al Maksimiljan Dhima: maksimiljan.dhima@gmail.com
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, por ai nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistencë ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi. Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme me qëllim integrimin e prioritetëve, qëllimeve dhe objektivave të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivelin qendror, qarku dhe vendor, si dhe masave të tjera. Janë disa direktiva dhe vendime të BE-së me rëndësi të veçantë në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile të cilat kanë nevojë për përafrim.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i> Të zvogëlohet risku nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të	

riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjithë subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij.

- Të forcohet sistemi i mbrojtjes civile nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).
- Të forcohen kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësisë të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, qarku dhe vendor.
- Të përmirësohet edukimi për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.
- Të parashikohen rregulla më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitucional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe procedurave përkatëse.
- Të rritet roli ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve /kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

Opsioni 0 (status quo): Procedurat të vijnë me kuadrin ekzistues në fuqi: Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues, ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar.

Opsioni 2: Të hartohet dhe miratohet një ligj i ri gjithëpërfshirës.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Zbatimi i opsionit të preferuar shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi, mund të sjellë shtimin e disa kostove në buxhetin e shtetit, të cilat përlllogariten në vlerën e 131’815’000 lekë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/preferuar është Opsioni 2. Ky opsion do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri jo vetëm për menaxhimin e fatkeqësive, por edhe për vendosjen e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë evropiane dhe botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Ky është opsioni i vetëm që do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore si dhe do të kontribuojë në integrimin e Shqipërisë në BE.

Gjithashtu, ky opsion është dhe një hap tjetër në përafrimin e legjislacionit tonë me *Acquis* e BE-së.

Aktualisht nuk mund të vlerësohen me saktësi ndikimet ekonomiko-financiare, pasi impakti i projektligjit është ndërinstitucional madje edhe në të gjithë shoqërinë. Do të theksonim këtu sanksionimin nëpërmjet projektligjit të çvendosjes së fokusit nga menaxhimi i fatkeqësive tek menaxhimi i risqeve të tyre me një theks të veçantë në parandalimin e risqeve të reja. Në kuadër të

parandalimit të risqeve të reja të fatkeqësive theksojmë njëherë nga parimet e OKB-së se 1 USD i investuar në parandalimin e fatkeqësive kursen 4-7 USD në fazën e përgjigjes ndaj tyre. Parë në këtë këndvështrim, në kuadër të vendosjes nëpërmjet projektligjit të tavanëve të detyruara buxhetore për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile në ministrinë kryesore dhe në të gjitha bashkitë, edhe financimi i pritshëm si në nivelin qendror edhe në atë vendor do të shumëfishohet krahasuar me të sotmin. Duke marrë parasysh raportin e sipërpërmendur, edhe përfitimet e shoqërisë në përgjithësi, nëpërmjet implementimit të ligjit do të jenë shumë të mëdha. Kjo do të sjellë, ndër të tjera, realizimin e investimeve të informuara rreth riskut të cilat sëbashku me transformimet e mëdha në këtë sektor, do të kenë si rezultat rritjen e mirëqenies së popullsisë dhe zhvillimin e qendrueshëm të ekonomisë së vendit.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
131 815 000	131 815 000	131 815 000

KONSULTIMI

Jepni një përmblendhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyt pse?)

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 24.05.2018. Në hartimin e projektligjit u shfrytëzua versioni i përgatitur nga grupet e punës së ngritura me Urdhër të Kryeministrit Nr.117, datë 18.07.2016 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Konsultime mbi projektligjin janë kryer me ekspertët e SIGMA dhe online, nëpërmjet regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mbrojtjes. Grupet e interesit, banorët e njësive administrative dhe njësitë administrative të zonave të prekura nga emergjencat civile nuk kanë shprehur komente apo mendime gjatë procesit të konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin, do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), si dhe të gjithë strukturat qendrore, vendore dhe operacionale të mbrojtjes civile. Ndër të tjera, monitorimi nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), do të kryhet nëpërmjet inspektimeve për institucionet, strukturat shtetërore, subjektet private dhe vendosjes së gjobave për shkelësit e ligjit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, por ai nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, paralajmërimi i hershëm, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Gjatë këtyre viteve ka pasur një nevojë gjithnjë e më rritje për një shtim të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të DPEC-së. Por ndryshimet e mëdha të ndodhura në këto vite në të gjithë sektorët, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nevoja për anëtarësimin sa më të shpejtë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, kanë bërë imediate një rritje të kapaciteteve të DPEC-së, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të saj në kontekstin e ri të krijuar.

Shqipëria është në dhjetë vendet e botës me risk më të lartë ekonomik nga risqet e shumëfishta: 86 % e territorit të saj ku prodhohet 88.5 % e GDP-së janë të ekspozuara ndaj dy ose më shumë rreziqeve; Sipas Raportit të Riskut Botëror 2016, të botuar nga Universiteti i Kombeve të Bashkuara-Instituti për Mjedisin dhe Sigurinë Njerëzore, që ka përllogaritur indeksin e riskut nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2016 në 171 vende të botës, bazuar në ekspozimin, prekshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe atyre përshtatëse, Shqipëria renditet në vendin e parë në Evropë dhe në vendin e 40-të në botë, gjë që vjen si pasojë e rritjes vit pas viti të prekshmërisë së saj nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së ndjeshmërisë ndaj tyre, pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përballuese dhe atyre përshtatëse.

Sipas Bankës Botërore, Shqipëria ka humbje mesatare vjetore nga tërmetet që vlerësohet të jetë 6.23% të PBB-së dhe humbje mesatare vjetore nga përmbytjet 1.56% e PBB-së.

Sipas Bankës Botërore, humbjet nga një tërmet i madh me periudhë rikthimi 250-vjeçare do të ishin 60% e PBB-së, ndërsa nga një tërmet me periudhë rikthimi 100-vjeçare, 30% e PBB-së.

Në periudhën që nga miratimi i ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, kanë ndodhur ndryshime dhe zhvillime të shumta, si në fushën e emergjencave, ashtu edhe në sektorë të tjerë me ndikim në të, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues të emergjencave civile dhe dokumenteve themelore, si: Plani Kombëtar për Emergjencat Civile i vitit 2004, dokumenti “Vlerësimi i risqeve nga Fatkeqësitë” i vitit 2003.

Referuar detyrimeve të tjera ndërkombëtare si më poshtë vijon:

Raporti Komandës Amerikane në Evropë/EU US Command, korrik 2014:

“Elementi më kritik i përmirësimit të kapacitetit të gatishmërisë/përgjigjes së organizatës së emergjencave civile në Shqipëri është një organizatë efektive e emergjencave civile. DPEC ka burime të pamjaftueshme dhe autoritet të kufizuar, të cilat pengojnë aftësinë e saj për të udhëhequr përpjekjet e gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive të Qeverisë së Shqipërisë”; (faqe 8).

-Rekomandimet e detajuara për të rritur DPEC në nivelin e Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile janë në çështjen 1; (faqe 16)

-Nuk ekziston një organ ndërinstitucional i nivelit të punës që koordinon aktivitetet e lidhura me fatkeqësitë. Organizata më e përshtatshme për të siguruar këtë koordinim gjithëpërfshirës është DPEC, aktualisht e organizuar nën Ministrinë e Brendshme. Sidoqoftë, DPEC ka personel, financim ose autoritet të pamjaftueshëm për të funksionuar në mënyrë efektive; (faqe 17)

-Kalimi i DPEC në një Agjenci Kombëtare të Emergjencave Civile që vepron nën Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave dhe identifikimin e kërkesave të fuqisë punëtore. (faqe 18).

Së dyti , në konkluzionet e vlerësimit të Ekipit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian/ UCPM, të hartuar pas përmbytjeve të shkurtit 2015:

DPEC ka mungesa stafi dhe kapaciteti për të menaxhuar fatkeqësi natyrore të përmasave të mëdha”.

Së treti, referuar konkluzioneve të raportit të prillit 2015 pas përmbytyjeve të mëdha në jug të vendit, të asistuar nga OKB, Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian “Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësisë”:

“Për të qenë në gjendje që të organizojë Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre në një mënyrë efektive, qeveria duhet të disponojë një sistem, i cili të mund të koordinojë aktivitetet për parandalimin dhe përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe ku të rregullohet e drejta për të marrë masat e nevojshme në fazat e paralajmërimit të hershëm dhe përgjigjes ndaj një përmbytyjeje. Në sistemin e tanishëm, e drejta, kapaciteti dhe financimi i organizatave përkatëse është i kufizuar(faqe 74).

Gjatë përgjigjes nevojitet e drejta për Autoritetin e Mbrojtjes Civile në të tre nivelet e qeverisjes, për të ndërmarrë veprim. Autoritetet e Mbrojtjes Civile në të tre nivelet e qeverisjes duhet të jenë në gjendje që pa marrë leje apo buxhet, të ndërmarrin veprime gjatë një situatë krize. Nevojitet një autorizim që të përshkruajë fuqitë e tyre brenda qeverisjes. (faqe 75).

Së katërti, referuar raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018: *Nuk ka strategji të mbrojtjes civile dhe ekziston një kapacitet i kufizuar administrativ.*

Problemi në shqyrtim

- Përshkruani natyrën e problemit.
- Identifikoni shkaqet e problemit.
- Përshkruani shtrirjen e problemit.
- Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.
- Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Përshkrimi i natyrës së problemit:

Ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, nuk ka asnjë parashikim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka gjithashtu mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, paralajmërimi i hershëm, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi. Edhe përcaktimet e tij për institucionet dhe strukturat qendrore dhe ato vendore sikurse strukturat operacionale të cilat janë përbërëse të sistemit të mbrojtjes civile janë evidentuar prej vitesh që janë sa të cekëta aq edhe të pamjaftueshme për kohën.

OKB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë politikave të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe kjo ka filluar që në vitet 90 me Strategjinë dhe Planin e Veprimit Yokohama për një Botë më të Sigurt, 1995-2005 të miratuar në vitin 1994 i cili është dokumenti i parë që ofron udhëzime në nivel ndërkombëtar për përgatitjen dhe parandalimin dhe zbutjen e impakteve të fatkeqësive. Edhe pse ligji “Për mbrojtjen civile” është miratuar 6 vjet pas miratimit të dokumentit të mësipërm, fatkeqësisht nuk ka asnjë referencë ndaj këtyre politikave të pranuara ndërkombëtarisht. Aktualisht kemi Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, miratuar në Konferencën e 3-të Botërore të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në 18.3.2015 në Japoni, si dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në 3.6.2015. Në vijim është miratuar Plani i Veprimit të Komisionit Evropian mbi implementimin e Sendai-it, si dhe Plani i Veprimit të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive për Aftësinë Ripërtëritëse. Është shumë e rëndësishme gjithashtu zbatimi i politikave kombëtare që marrin parasysh lidhjen midis implementimit të Kuadrit Sendai, Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm, Marrëveshjes së Parisit për Ndryshimet Klimatike dhe Axtendës Urbane. Të gjitha këto politika botërore dhe detyrimet dhe angazhimet përkatëse që Shqipëria ka marrë përsipër për implementimin në praktikë të tyre imponojnë edhe nevojën e ndryshimeve të thella ligjore që do ta mundësojnë këtë në praktikë.

Ndryshimet e mëdha të ndodhura në këto vite në të gjithë sektorët, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nevoja për anëtarësimin sa më të shpejtë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, kanë bërë imediate një shtim të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare në radhë të parë të DPEC-së

por edhe të institucioneve qendrore dhe vendore, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre në kontekstin e ri të krijuar.

Efektet e ndryshimeve klimatike në vendin tonë, sikurse edhe në vendet e tjera çojnë vazhdimisht në ndryshime në frekuencë, intensitet, shtrirjen hapësinore, kohëzgjatjen, dhe kohën e ndodhjes së ngjarjeve ekstreme të motit. Gjendja e fatkeqësive natyrore është përkeqësuar edhe më tej nga shkaqe me origjinë veprimtarinë njerëzore siç janë shfrytëzimi i papërshtatshëm i tokës, urbanizimi i pakontrolluar, shpyllëzimet etj.

Fatkeqësitë nuk njohin kufij dhe shpesh ato kanë karakter ndërkomunikues apo përfshijnë edhe më shumë se dy shtete. Si të tilla, ato kërkojnë edhe qasje të reja të cilat kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë me shtetet e tjera dhe koordinim të politikave respektive shtetërore.

Karakteret ndërsektorial të politikave të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile e ka bërë atë prej kohësh që të konsiderohet si një çështje e gjithë shoqërisë. Në këto kushte, angazhimi edhe i aktorëve private, është i domosdoshëm. Vullnetarizmi, në veçanti, referuar edhe përvojave të sukseshme të shteteve të tjera, është një domosdoshmëri për kushtet specifike të vendit tonë.

Identifikimi i shkaqeve të problemit:

Baza ligjore aktuale është e vakët, duke mos përcaktuar aspekte thelbësore të mbrojtjes civile. Nuk ka parashikim për edukimin, trajnimin, asistencën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, paralajmërimit të hershëm, njoftimit, alarmit etj. Në mënyrë të veçantë kjo bazë ligjore është krejtësisht e vjetëruar pasi nuk pasqyron aspak politikat e pranura ndërkombëtarisht të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive por edhe politika të tjera të lidhura ngushtësisht me to siç janë Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës dhe Agjenda e Re Urbane. Gjithashtu, në stadin aktual nuk është bërë ende implementimi në të gjithë vendin i numrit të thirrjeve pa pagesë 112, si numri i vetëm evropian i thirrjeve emergjente.

Përshkrimi i shtrirjes së problemit:

Problemi që kërkon të zgjidhet shtrihet nga periudha e miratimit të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile” i ndryshuar, i cili ka nevojë për plotësime të shumta si më poshtë:

- Të gjitha detyrimet e ministrive për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile. Për këtë arsye janë saktësuar dhe shtuar detyrime të tilla siç janë ato për hartimin, miratimin dhe përditësimin e Planit për Emergjencat Civile, planifikimin buxhetor 2-4% të totalit të buxhetit vjetor që luhetet ndërmjet vlerave 7 milionë e 957 mijë deri në 15 milionë e 914 mijë lekë, kryerjen e vlerësimit të humbjeve nga fatkeqësitë sipas fushës së përgjegjësisë dhe krijimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësisë
- Detyrimet e institucionit të Prefektit janë zgjeruar dhe saktësuar duke shtuar detyra të tilla si për përgatitjen e vlerësimit të riskut të fatkeqësive, planit të emergjencave civile, sigurimin e funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut dhe bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku.
- Detyrimin e bashkisë janë saktësuar dhe zgjeruar duke shtuar detyra të tilla si planifikimi i të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. për përgatitjen e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimit të riskut të fatkeqësive, planit vendor të emergjencave civile, sigurimin e funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e tyre, kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë, kryerjen e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme në territorin e tyre dhe bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel bashkie.

- Detyrimin e institucioneve publike, strukturave qendrore dhe vendore, apo subjekteve private që kanë në administrim apo pronësi infrastrukturë kritike për të hartuar dhe përditësuar dokumentin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë, si edhe Planin për Emergjencat Civile;
- Detyrimin e institucioneve shtetërore dhe subjekteve private në sektorët e shëndetësisë, arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, mjedisit dhe turizmit, që të hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë Planin për Emergjencat Civile.
- Detyrimin e institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve kërkimore-shkencore, enteve të ndryshme publike dhe private, si dhe organizatave të tjera të angazhuara në punë kërkimore dhe shkencore me detyra të tilla si njoftimi i AKMC-së rreth zbulimeve shkencore në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; kryerjen e veprimtarive kërkimore - shkencore në interes të mbrojtjes civile, angazhimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për nevojat e strukturave të mbrojtjes civile; promovimin e veprimtarive kërkimore - shkencore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes civile, në shërbim të mbrojtjes civile”.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile përmban tashmë përcaktime të sakta për çështjet që ai përfshin, sikurse për marrjen e asistencës ndërkombëtare, kalimin e kufirit dhe për herë të parë edhe për dhënien e asistencës jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.
- Të drejtat dhe detyrimet e shtetasve subjekteve private dhe organizatave jofitimprurëse janë plotësuar dhe qartësuar thelbësisht në projektligj.
- Arsimimi dhe trajnimi janë përcaktuar në projektligj ku Ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile siguron përfshirjen në programet mësimore të njohurive për mbrojtjen civile. AKMC, nëpërmjet Qendrës së Trajnimeve për mbrojtjen Civile, kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllim.
- Kundrejt një përcaktimi shumë të përgjithshëm dhe si rrjedhim edhe të pa implementueshëm në nenin e sanksioneve të ligjit në fuqi, projektligji përcakton të gjitha llojet e shkeljeve dispozitave të këtij ligji nga subjektet privatë dhe nga titullarët e institucioneve shtetërore. Është përcaktuar edhe konstatimi i shkeljeve, ankimi dhe ekzekutimi i vendimit.
- Implementimin e numrit 112 pa pagesë në rrjetet telefonike publike, si dhe në rrjetet digjitale të shërbimeve të integruara dhe shërbimet publike mobile, si numri i vetëm evropian i thirrjeve emergjente;

As ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 dhe as ndonjë akt tjetër ligjor shqiptar i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nuk përfshin dispozita që kanë të bëjnë me tematikat brenda objektit që mbulohen nga Direktivat dhe vendimet e cituara në hyrje të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit.

Grupet e prekura nga ky problem:

1. Ministrinë.
2. Prefekturat dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
2. Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile.
3. Grupe të tjera interesi në vartësi objektit/rastit;
4. Qytetarët (Qytetarët kanë të drejtë të informohen në mënyrë të përhershme dhe të përditësuar për risqet nga fatkeqësitë, si edhe për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre.)

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Arsyeja e ndërhyrjes lidhet me faktin se legjislacioni aktual në fuqi në fushën e emergjencave civile paraqet një sërë mangësish, të cilat ndikojnë në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave civile parandalim-gadishmëri-përgjigje-rimëkëmbje.

Gjithashtu ligji aktual nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Shqipëria është në dhjetë vendet e botës me risk më të lartë ekonomik nga risqet e shumëfishta: 86 % e territorit të saj ku prodhohet 88.5 % e GDP-së janë të ekspozuara ndaj dy ose më shumë rreziqeve;

Sipas Raportit të Riskut Botëror 2016, të botuar nga Universiteti i Kombeve të Bashkuara-Instituti për Mjedisin dhe Sigurinë Njerëzore, që ka përllogaritur indeksin e riskut nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2016 në 171 vende të botës, bazuar në ekspozimin, prekshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe atyre përshtatëse, Shqipëria renditet në vendin e parë në Evropë dhe në vendin e 40-të në botë, gjë që vjen si pasojë e rritjes vit pas viti të prekshmërisë së saj nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së ndjeshmërisë ndaj tyre, pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përballuese dhe atyre përshtatëse.

Sipas Bankës Botërore, Shqipëria ka humbje mesatare vjetore nga tërmetet që vlerësohet të jetë 6.23% të PBB-së dhe humbje mesatare vjetore nga përmbytjet 1.56% e PBB-së.

Sipas Bankës Botërore, humbjet nga një tërmet i madh me periudhë rikthimi 250-vjeçare do të ishin 60% e PBB-së, ndërsa nga një tërmet me periudhë rikthimi 100-vjeçare, 30% e PBB-së.

Në periudhën që nga miratimi i ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, kanë ndodhur ndryshime dhe zhvillime të shumta, si në fushën e emergjencave, ashtu edhe në sektorë të tjerë me ndikim në të, në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Si rrjedhojë, nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues të emergjencave civile dhe dokumenteve themelore, si: Plani Kombëtar për Emergjencat Civile i vitit 2004, dokumenti “Vlerësimi i risqeve nga Fatkeqësitë” i vitit 2003 me qëllim adresimin e problematikave të sipërcituara.

Nëpërmjet prioritizimit dhe implementimit në praktikë të politikave efikase bashkëkohore për reduktimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, Shqipëria do të jetë edhe një eksportuese e sigurisë edhe në rajon edhe më gjerë duke qenë në këtë mënyrënjë anëtar i denjë i NATO-s dhe organizmave të tjera ndërkombëtare dhe një aspirant për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, modernizimi i sistemit të mbrojtjes civile do të kishte si arritje të tij të parë madhore, anëtarësimin e shpejtë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane.

Për më tepër, nëpërmjet kësaj ndërhyrje synohet të arrihet paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë:

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 78, datë 24.05.2018, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për mbrojtën civile”, me objekt pune hartimin e projektligjit për të përafuar pjesërisht legjislacionin e brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian.

Grupi Ndërinstitucional i Punës kishte në përbërje përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Në hartimin e projektligjit u shfrytëzua versioni i përgatitur nga grupet e punës së ngritura me Urdhër të Kryeministrit Nr.117, datë 18.07.2016 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
- Të zvogëlohet risku nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjithë subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij.
- Të forcohet sistemi i mbrojtjes civile nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).
- Të forcohen kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësive të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, qarku dhe vendor.
- Të përmirësohet edukimi për mbrojtjen civile në shkolla, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar.
- Të parashikohen rregulla më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitucional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe procedurave përkatëse.
- Të rritet roli ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0: Status Quo

Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar. Ky opsion nuk sjell asnjë ndryshim, dhe nuk rregullon dhe as përmbush hapësirat dhe vakumet ligjore që janë aktualisht në legjislacionin shqiptar.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar.

Për shkak të përmbajtjes së vakët të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, nevojave për ndryshime thelbësore në përcaktimet ekzistuese por edhe shtesat e shumta në ligjin e ri, vlerësojmë se ndryshimi i ligjit ekzistues, nuk do të zgjidhë aspak problemet dhe vështirësitë e hasura nga praktika, dhe as do të plotësojë hapësirat ligjore ekzistuese në legjislacionin tonë.

Opsioni 2: Të hartohet dhe miratohet një ligj i ri gjithëpërfshirës.

Vetëm ky opsion do të sjellë plotësimin e vakumeve thelbësore ligjore për problematikat e shumta të hasura në fushën e mbrojtjes civile.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Opsioni 2 - Hartimi i këtij projektligji synon ngritjen në një nivel më të lartë të efektivitetit të sistemit të mbrojtjes civile, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, si dhe implementimin për herë të parë të masave shumë sektoriale në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.

Nga ky ligj i ri preken tre grupe interesi: biznesi, qytetarët dhe qeveria/sektori publik.

Qeveria/sektori publik

Ndikime të drejtpërdrejta:

- Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike etj.
- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional dhe atij ndërkombëtar.
- Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila, krahasuar me organizimin aktual të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, do të ketë kapacitete më të mëdha administrative, teknike dhe financiare, sikurse autoritet, përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera.
- Rritja e rolit të prefektit të qarkut dhe bashkive në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
- Përmirësimi thelbësor i edukimit dhe trajnimit.
- Rritja e rolit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit, alarmit, krijimit dhe të ruajtjes së bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në menaxhimin e fatkeqësive;
- Zbatimi i masave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në nivelin qendror dhe vendor sikurse në subjektet private.
- Marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore

- Ulja e numrit të kërkesave për dëmshpërblim si pasojë e menaxhimit më të mirë dhe efikas të situatave emergjente dhe pakësim i shpenzimeve në përgjithësi për menxhimin e fatkeqësive.
- Ulja e kostove gjatë fazës së përgjigjes ndaj fatkeqësive si rezultat i implementimit të masave të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe atyre zbutëse dhe parandaluese ndaj fatkeqësive.
- Planifikimi buxhetor 2-4% i totalit të buxhetit vjetor për të ministrive dhe bashkive për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

Progresi në zbatimin e Kuadrit Sendai është përparim drejt përmbushjes së OZHQ-ve dhe anasjelltas. Ka një numër objektivash në 17 OZHQ-të që lidhen me DRR. Anasjelltas, të shtatë objektivat globale të Kuadrit Sendai janë kritike për arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Më saktësisht, janë 11 indikatorë të OZHQ-ve që lidhen me 5 indikatorë të Kuadrit Sendai (Objektivat A,B,C,D dhe E)

Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike u miratua më 12.12.2015 në sesionin e 21-të të Konferencës së Palëve në Konventën Kuadër të OKB mbi Ndryshimet Klimatike. Ligji Nr. 75/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike” është miratuar në 14.7.2016.

Tashmë është e gjithë pranuar lidhja mes ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive. Kështu sipas UNISDR; “Fatkeqësitë, shumë prej të cilave janë përkeqësuar nga ndryshimet klimatike dhe rriten në frekuencë dhe intensitet, pengojnë dukshëm progresin drejt zhvillimit të qëndrueshëm”. Përfundimisht nënvizojmë faktin se ekziston një lidhje e ngushtë midis të triave; OZHQ, Ndryshimeve Klimatike dhe Kuadrit Sendai dhe si rrjedhim implementimi i politikave të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në përputhje me Kuadrin Sendai, është njëkohësisht edhe progres në implementimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Parisit dhe OZHQ-ve.

Detyrimet sipas këtij ligji të institucioneve qendrore por edhe të bashkive do të kenë impakt të qenësishëm në strategjitë dhe politikat e tyre të zhvillimit, siç janë ato të zhvillimit urban dhe të planifikimit të tokës.

Biznesi dhe qytetarët

Ndikime të drejtpërdrejta:

- Ulja e prekmërisë së bizneseve nga fatkeqësitë si pasojë e marrjes së masave respektive parandaluese.
- Rritja e nivelit të edukimit dhe trajnimit të punonjësve të bizneseve dhe i qytetarëve për përballimin e situatave emergjente.
- Rritja e nivelit dhe cilësisë së paralajmërimit të hershëm dhe alarmit në rastin e një situatë emergjente.
- Rritja e performancës së bizneseve si pasojë e marrjes së masave nga ane e tyre për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile.

Ndikime jo të drejtpërdrejta:

Përmirësimi i proceseve të identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të risqeve në të tre nivelet si pasojë e angazhimit në këtë sektor edhe të subjekteve private.

Rritja e performancës së bashkive si pasojë e detyrimit të vendosur për planifikuar të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Risqet më të mëdha për të penguar realizimin e pritshmërive pas miratimit të ligjit të ri “Për mbrojtjen civile” janë si vijojnë:

- Moszbatimi korrekt i ligjit nga subjektet e detyruara.
- Mungesa e rakordimit ndërmjet institucioneve të ngarkuara me zbatimin e ligjit.
- Mos miratimi nga ana e Kryeminitrisë së përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Mungesa e kapaciteteve për hartimin e strategjive të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive, planeve të emergjencave civile dhe vlerësimit të riskut të fatkeqësive.
- Mos parashikimi nga ana e ministrive e 2-4% të buxhetit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
- Mos parashikimi nga ana e bashkive e 4% të totalit të buxhetit vjetor, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 2, pra hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për mbrojtjen civile është më i preferuari, pasi:

Së pari: Hartimi i një ligji të ri ishte e vetmja mundësi për të përmbushur qëllimin për krijimin e një kuadri rregullator gjithëpërfshirës në fushën e mbrojtjes civile;

Së dyti: Projektligji rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

Së treti: Ky projektligj do të sigurojë përshtatjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile me standardet evropiane, në përputhje edhe me prioritetet e Kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe do të garantojë anëtarësimin e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të preferuar, ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), si dhe të gjithë strukturat qendrore, vendore dhe operacionale të mbrojtjes civile sipas përcaktimeve në projektligj.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur janë si vijojnë:

- Moszbatimi korrekt i ligjit nga subjektet e detyruara.
- Mungesa e rakordimit ndërmjet institucioneve të ngarkuara me zbatimin e ligjit.
- Mos miratimi nga ana e Kryeministrit së përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Mungesa e kapaciteteve për hartimin e strategjive të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive, planeve të emergjencave civile dhe vlerësimit të riskut të fatkeqësive.

- Mos parashikimi nga ana e ministrive e 2-4% të buxhetit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
- Mos parashikimi nga ana e bashkive e 4% të totalit të buxhetit vjetor, nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Si masa për zbatimin e këtij opsioni, renditen si më poshtë vijon:

- Hartimi i akteve nënligjore, të cilat do të detajojnë procedurat dhe strukturat përgjegjëse për realizimin e objektivit;
- Përcaktimi i formave/mjeteve të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në zbatimin e ligjit.
- Përcaktimi i numrit të thirrjeve pa pagesë 112, si numri i vetëm evropian i thirrjeve emergjente.
- Monitorimi konstant i çështjeve të Mbrojtjes Civile nga AKMC (aktualisht DPEC), sipas kompetencave të njohura nga ligji.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Për monitorimin e opsionit të preferuar, do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), si dhe të gjithë strukturat qendrore, vendore dhe operacionale të mbrojtjes civile. Ndër të tjera, monitorimi nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), do të kryhet nëpërmjet inspektimeve për institucionet, strukturat shtetërore, subjektet private dhe vendosjes së gjobave për shkelësit e ligjit.

Treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre janë monitorimi konstant i çështjeve të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile nga AKMC (aktualisht DPEC), sipas kompetencave të njohura nga ligji.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Njësia e përdorur: lekë

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1	0.9528	0.9078	0.865	0.8242	0.7853	0.7483	0.7130	0.6794	0.64737
		35	94	073	71	94	51	55	23	8
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'8 15'00 0	131'81 5'000
Kosto për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'8 15'00	131'81 5'000

	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	131'8 15'00 0	125'5 97'94 5	119'6 74'04 7	114'0 29'59 7	108'6 51'28 2	103'5 26'71 0	98'64 3'887	93'99 1'345	89'55 8'143	85'334' 131
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi në total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlera aktuale e koston në total	1'070' 822'1 47									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	- 1'070' 822'1 47									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	1'070'822'147	0	-1'070'822'087
Opsioni 2	1'070'822'147	0	-1'070'822'087

Opsioni 2 është opsioni optimal, pasi vetëm ky opsion do të sjellë plotësimin e vakumeve thelbësore ligjore për problematikat e shumta të hasura në fushën e mbrojtjes civile. Edhe pse vlera aktuale neto për të dy opsionet është e njëjtë, opsioni 2 ka më shumë përfitime të cilat nuk mund të maten.